



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHLLI

Nr. 60, prot

Datë 04/03 /2024

VENDIM

Nr. 09, datë 29/02/2024

PËR
NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 35, DATË 29/12/2023, "PËR
SHPËRNDARJEN E TRANSFERTËS SË PAKUSHTËZUAR TË
TRASHËGUAR, TË ARDHURAVE TË TRASHËGUARA DHE
TRANSFERTËS SPECIFIKE TË TRASHËGUAR NGA VITI 2023".

Këshilli i Bashkisë Fushë Arrëz në mbledhjen e tij të datës së mësipërme, në zbatim të Ligjit nr. 115/2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të Njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni "18", neni "34", neni "40", neni "41", neni "54" germa "Dh", neni "55" pika 3, neni "64" germa C, Ligjit 68/2017 datë 27/04/2017. "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni "4", neni "5" gjerat "a & ç", neni "6" germa "d", neni "7" pika "1", neni "21" pika "3", neni "23", neni "33", neni "39", neni "40", neni "41", Ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008, "Për Menaxhimin e sitemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit 84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023", Ligjit 97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024", Ligjit 10296, datë 08/07/2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Udhëzimit nr. 6, datë 28/02/2023 "Për përgatitjen e programit buxhetore afatmesëm 2024-2026", Udhëzimit nr. 23, datë 30/07/2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetorë afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore", Udhëzimit nr. 9, datë 20/03/2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar, Akt-rakordimit ndërmjet Bashkisë Fushë Arrëz dhe Degës së Thesarit Pukë për Transfertat dhe të ardhurat e trashëguara nga viti 2023, Si dhe Marrveshjes nr. 474, prot. Datë 16.2.2024, pas diskutimit nga Këshilltarët;

VENDOSI:

1. Të miratojë shpërndarjen e shumës prej 451 mijë lekë për projektin Qendër komunitare për rintegrimsocialia të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes sociale dhe Bashkisë Fushë Arrëz.

2. Kjo shumë financohet nga Transferta e pakushtëzuar e trashëguar e vitit 2023 dhe do të përdoret për zërin Blerje ushqime (3.22.5) ,që sistemohet në programin buxhetorë si mëposhtë:

000/lekë

Gr.	Tit.	Kap.	Viti	Artikull				Shuma
				600	601	602	231	
00	10430	01	2024			451		451
Totali						451		451

3. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Seksioni i Financës, Zyra e Çeshtjeve Sociale, Inspektroi për informimin publik në Bashkinë Fushë-Arrëz, si dhe Dega e Thesarit Pukë.

Ky vendim mori:

11 vota pro.

0 Vota kundër.

0 Vota abstenim.

Vendimi u zbardh me datë 4/3/2024.

SEKRETARI

Tom CURRI



KRYETARI

Nikolin BARDHOKU

